

PROTOKOLL

I SHKEMBIMIT TE INSTRUMENTAVE TE RATIFIKIMIT

Te nenshkruarit, Zoti Paskal Milo, Ministri Shqiptar i Puneve te Jashtme dhe Zoti Risto Nikovski, Ambasadori i Jashtezakonshem dhe Fuqiplote Maqedon ne Tirane, jane takuar sot me Dy Shtator Njemije e Nenteqind e Nentedhjete e Tete, ne Tirane, per te bere shkembimin e Instrumentave Ratifikimit te:

1. "Marreveshjes midis Qeverise Shqiptare dhe Qeverise Maqedone per shmangjen e tatimeve te dyfishta lidhur mbi tatimet mbi ardhurat dhe mbi kapitalin per parandalimin e evazionit fiskal", nenshkruar ne Shkup, me Pesembedhjete Janar Njemije e Nenteqind e Nentedhjete e Tete.

Ne perputhje me Nenin 29, Pika 2 e kesaj Marreveshjeje, kjo Marreveshje hyn ne fuqi ne daten e shkembimit te Instrumentave te Ratifikimit.

2. "Marreveshjes midis Qeverise Shqiptare dhe Qeverise Maqedone per ndihmen juridike ne fushen civile dhe penale", nenshkruar ne Shkup, me Pesembedhjete Janar Njemije e Nenteqind e Nentedhjete e Tete.

Ne perputhje me Nenin 37, te kesaj Marreveshjeje, kjo Marreveshje hyn ne fuqi 30 dite pas dates se shkembimit te Instrumentave te Ratifikimit.

3. "Marreveshjes midis Qeverise Shqiptare dhe Qeverise Maqedone per ekzekutimin e ndersjellte te vendimeve gjyqesore per ceshtjet penale", nenshkruar ne Shkup, me Pesembedhjete Janar Njemije e Nenteqind e Nentedhjete e Tete.

Ne perputhje me Nenin 33, te kesaj Marreveshjeje, kjo Marreveshje hyn ne fuqi 30 dite pas dates se shkembimit te Instrumentave te Ratifikimit.


4. "Marreveshjes midis Qeverise Shqiptare dhe Qeverise Maqedone per Ekstradimet", nenshkruar ne Shkup, me Pesembedhjete Janar Njemije e Nenteqind e Nentedhjete e Tete.

Ne perputhje me Nenin 30, te kesaj Marreveshjeje, kjo Marreveshje hyn ne fuqi 30 dite pas dates se shkembimit te Instrumentave te Ratifikimit.

Dokumentat e paraqitura te Ratifikimit u gjeten te rregullta dhe ne formen e duhur dhe mbi kete baze u shkembyen nga nenshkruesit.

Bere ne Tirane, me Dy Shtator Njemije e Nenteqind e Nentedhjte e Tete, ne dy kopje ne gjuhet shqipe dhe maqedone.

Per Qeverine Shqiptare



Paskal Milo

**Ministri Shqiptar
i Puneve te Jashtme**

Per Qeverine Maqedone



**Ambasadori i Jashtezakonshem
dhe Fuqiplote Maqedon ne Tirane**